

01 Nr. 900/01 - 7971

Më 27/02/2025



KOMUNA E DRENASIT

**MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI
PËR TRAJTIMIN E QENVE ENDACAK NË KOMUNËN E DRENASIT**

Palët Nënshkruese:

1. Komuna e Drenasit përfaqësuar nga z. **Ramiz Lladroveci**, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejmë Komuna)
2. Fondacioni StrayCoCo / c/o Probst Partner AG Bahnhoplatz 18 8401 Winterthur, përfaqësuar nga **Znj. Helen Wormser** (në tekstin e mëtejmë fondacioni)

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është realizimi i projektit për trajtimin human të qenve endacak në territorin e Komunës së Drenasit e që për impakt do të ketë zvogëlimin e numrit të tyre, me qëllim të evitimit të rreziqeve të shëndetit dhe jetës së qytetarëve. Me këtë projekt gjithashtu arrihet qëllimi i parandalimit të përhapjes së sëmundjeve infektive si zoonozave, Tërbimit, përmes vaksinimit dhe ekinokokozes me tableta.

**Neni 2
Financimi i Projektit**

Komuna e Drenasit dhe Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbüelëg dakordohen që të bashkë financojnë realizimin e këtij projekti në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje.

**Neni 3
Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Marrëveshja lidhet në afat kohorë prej 12 muaj, nga dita e nëshkrimit nga të dy palët

**Neni 4
Lokacioni dhe trajtimi**

Trajetimi i qenve endacak sipas kësaj marrëveshje bëhet nga staf profesionit i veterinarisë i Ambulancës Veterinare të cilën e përzgjedhë Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbüelweg.

Neni 5
Obligimet e Përbashkëta të Palëve

Komuna e Drenasit dhe Fondacioni StrayCoCo do ti mbulojnë shpenzimet e trajtimit veterinar, për 500 qenë endacak, brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muaj sa do të zgjas kjo marrëveshje. Në kuadër të këtij numri të qeneve të trajtuar nuk përfshihen edhe rastet e eutanazisë.

Neni 6
Obligimet e Komunës së Drenasit

- 6.1 Komuna e Drenasit do të participoj nga buxheti i saj për shërbimet veterinare që do të kryhen për qenë endacak, në bazë të çmimeve të përcaktuar në nenin 8 të kësaj marrëveshje.
- 6.2 Komuna e Drenasit do të i inkurajojë qytetarët, pronarët e qenve që nuk kanë mundësi pagese për një konsultë veterinare për ti sjellë qentë e tyre, veçanërisht qentë femra, në Ambulancën Veterinare të cilën e përzgjedh Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbüelweg, për sterilizim, vaksinim dhe dhënien e tabletave antiparazit falas nga Fondacioni.
- 6.3 Komuna e Drenasit do të organizojë fushatë informuese të qytetarëve në lidhje me programin e Sterilizimit dhe kastrimit në vazhdim.

Neni 7
Obligimet e Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbüelweg

Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbüelweg merr për obligim që nga stafi veterinar i Ambulancës Veterinare të cilën e përzgjedhë, të i kryej këto shërbime veterinare:

- 7.1 Kapjen e qenve endacakë,
- 7.2 Trajtimin (kontroll, ushqim, vaksinim, dehelmentizim, identifikim, matrikul),
- 7.3 Kastrimi/sterilizimi,
- 7.4 Hospitalizimi (3 ditë tek meshkujt dhe 5 ditë tek femrat),
- 7.5 Vaksinimi i qenve me dy Vaksina, vaksinë polivalente dhe vaksinë kundër Tërbimit (rabies),
- 7.6 Tableta antiparazit për 500 qenë,
- 7.7 Lëshimi në vendin e kapjes,
- 7.8 Eutanazia për qentë e sëmurë dhe agresiv (kryerja e procesit te eutanazisë),
- 7.9 Ambulanca Veterinare që e përzgjedhë fondacioni, kontrollon dhe monitoron çdo qen endacak i cili duhet të ketë të dukshëm matrikulën në vesh që është i identifikuar dhe regjistruar se qeni është i sterilizuar, vaksinuar dhe trajtuar siç duhet dhe gjatë trajtimit duhet që patjeter të jetë prezent edhe menaxheri i projektit i caktuar nga Komuna.
- 7.10 Çdo qen regjistrohet në një regjistrer/raport/ së bashku me një fotografi me matrikulë në vesh, me numër të dukshëm . Ky raport i kontrollit rregullisht do të ju prezantohet fondacionit StrayCoCo dhe menaxherit të projektit , përkatësisht Komunës.

Neni 8
Kostoja financiare – çmimet e trajtimit

- 8.1 Në realizimin e këtij projekti Fondacioni Straycoco merr pjesë me mjete financiare në përqindje prej 55 %, ndërsa komuna e Drenasit me 45 %.
- 8.2 Kostoja për këtë trajtim për secilin qenë është 60.00 € (gjashtëdhjetë euro). Fondacioni StrayCoCo do të mbulojë koston për 33.00 € (tridhjetë e tri euro) dhe pjesa tjetër prej 27.00 € (njëzetë e shtatë euro) do të mbulohet nga Komuna e Drenasit.

JEP

8.3 Për rastet e Eutanazisë do të paguhet 10 euro nga komuna dhe pjesa tjeter prej 10 euro nga fondacioni Straycoco, pas vërtetimit të veterinerit dhe në pajtim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

8.4 Përshkrimi dhe çmimet për shërbimet veterinare që do të kryhen paraqitur në formë tabelare:

Nr.	Përshkrimi i shërbimit veterinar	Njësia	Çmimet	Pagesa kryhet nga:
1	Zënia/kapja e qenve endacak dhe vlersimi për gjendjen shëndetësore .	Krerë/copë	10.00€	Komuna
2	Kastrimi/Sterilizimi i qenve endacak.	Krerë/copë	33.00€	Fondacioni StrayCoCo
3	Trajtimi (kontrolli,ushqimi) identifikim i qenve endacak-matriku, vaksinimi. Hospitalizim (3 ditë meshkujve dhe 5 ditë femrave) dhe lëshimi i qenve të trajtuar në vendin e zënies-kapjes.	Krerë/copë	17.00€	Komuna
4	Total		60.00€	./...

8.5 StrayCoCo zotohet se qentë me lëndime trupore si: këmbë të thyera, plagë ose me zgjebë, do të trajtohen, do të hospitalizohen deri në shërimin e tyre. Shpenzimet për trajtim dhe hospitalizimin e këtyre rasteve i mbulon fondacioni StrayCoco. Qentë e sëmurë rëndë duhet të eutanizohen në mënyrë njerezore

Neni 9 Pagesa për shërbimet e kryera

Komuna do të kryej pagesat për shërbimet veterinare të kryera sipas kësaj marrëveshje në baza tre mujore, pas dorëzimit të faturës bashkë me raportin me shkrim të nënshkruar nga Menaxheri i projektit i caktuar nga Komuna e Drenasit. Pagesa do të bëhet me lejimin e buxhetit në fillim të vitit 2025 dhe do të realizohen për çdo tre mësues.

Neni 10 Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

10.1 Me pëlgimin paraprak të palëve nënshkruese kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

10.2 Komuna mban të drejtën e ndërprerjes së pagesës së shërbimeve për këtë destinim në rast se konstaton se fondacioni StrayCoCo nuk i përbashë obligimet e veta nga kjo marrëveshje.

Neni 11 Mbikëqyrja e Zbatimit të Marrëveshjes

Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj marrëveshje nga komuna do ta bëjë menaxheri i projektit i cili do të caktohet me vendim të Kryetarit të Komunës, ndërsa nga pala tjetër përfaqësuesi caktuar prej saj.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët pajtohen që mosmarrëveshet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim, të kundërtën çështja do të kalohet në Gjykatën kompetente.

RJD

Neni 13
Numri i ekzemplarëve


Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në tre ekzemplarë në origjinal, prej të cilëve dy për komunën dhe një për palën tjetër nënshkruese. Marrëveshja përmban 14 nene në katër (4) faqe A/4.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje të hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit ndërsa do të fillon të zbatohet nga data: 28/02/2025


Drenas, më: 27/02/ 2025

Komuna e Drenasit


z. Ramiz Lladrovci, Kryetar



Fondacioni StrayCoCo – 26.02.2025


Dr. Helen Wormser